



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:003451

Datë: 06.07.2022

Numri i dokumentit: 03206502

**P. nr.101/22/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit R. S. nga Gjakova , për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par.3 lidhur me par. 2 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP/II.nr. 1819/22 të dt.08.03.2022,në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **04.07.2022**, në prani të Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj si dhe të akuzuarit, me dt. 05.07.2022 mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **R. S.**, nga Gjakova, Rr ” . . . “ , data e lindjes . . . ,i biri i A. dhe i nënës Gj. e gjinisë M. , ka te kryer shkollën fillore , i pa punë , i gjendjes së dobët ekonomike , shqiptar ,shtetas R. Kosovës, i martuar ,atë i katër fëmijëve , me ID . . .

**Ë s h t ë f a j t o r**

**Sepse :**

**-me dt.01.12.2021 rreth orës 12:00, në Gjakovë**, i pandehuri me qëllim të shkakimit të frikësimit dhe ankthit, përmes telefonit, seriozisht e kanos me fjalë personin zyrtar në lidhje me punën e tij dhe atë të dëmtuarin B. B., Drejtor në shkollën “. . .” në Gjakovë, në atë mënyrë që si rrjedhojë e një mosmarrëveshje që kishin mes vete lidhur rreth një dëmi që e kishte shkaktuar djali i të pandehurit M.S, i cili e kishte dëmtuar derën e sallës së Edukatës Fizike, në shkollën “. . .”, ashtu që ditën kritike, i dëmtuari e kontakton me telefon të pandehurin për të biseduar rreth dëmit të shkaktuar nga fëmija i tij, i pandehuri në bisedë e sipër e ofendon të dëmtuarin me fjalët “*ta q... familjen, nanën e babën*” dhe pastaj e kanos me fjalët “*vi aty të mbys, te vras dhe te copëtoj, ki me pa çka ka me të gjet ty*, me ç ‘rast tek i dëmtuari shkakton frikë, ankth dhe pasiguri për jetën e tij.

**-me çka ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së.**

**Andaj Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39, 46, 47, 48, 49,69 ,70, neni 181 par.3 lidhur me par. 2 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :**

**DENIM ME KUSHT**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **8 (tetë ) muaj** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) vite**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I dëmtuari B.B. nga Gjakova , për realizimin e kërkesës pasurore juridike , udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30.00 €**, në afat prej **30 ditëve** pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr. 1819/22 të dt.08.03.2022, e ka akuzuar të akuzuarin R. S. nga Gjakova , për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par.3 lidhur me par. 2 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj , në shqyrtimin fillestar të mbajtur me dt.04.07.2022, lexoi aktakuzën PP/II.nr. 1819/22 të dt.08.03.2022, dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari R. S. ,në shqyrtimin fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë theksoi se e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet sipas aktakuzës duke i ditur edhe më parë pasojat dhe favorët juridike të pranimit të fajësisë, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer në afekt ,premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm, kërkojë falje nga i dëmtuari për veprimet e mija, andaj i propozoi gjykatës që të marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë në çdo fazë të procedurës , premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme ,kërkim falje nga i dëmtuari, gjendjen e dobët ekonomike, si dhe faktin se më parë nuk kam ra ndesh me ligjin, të më shqiptojë një dënim më të butë .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë Prokurori i shtetit Anton Hasanaj , deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu i akuzuari R. S. , pasi që të njëjtin pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion pas sqarimit të mjaftueshëm të bërë edhe nga ana e gjykatës dhe se ky pranim i fajësie ka mbështet të plotë edhe në provat që e mbështesin aktakuzën, andaj gjykatës i propozoi që të aprovojë pranimin e fajësisë dhe të akuzuarit ti shqiptoj një dënim konform ligjit dhe njëherë të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari R. S. : **-me dt.01.12.2021 rreth orës 12:00, në Gjakovë**, i pandehuri me qëllim të shkaktimit të frikësimit dhe ankthit, përmes telefonit, seriozisht e kanos me fjalë personin zyrtar në lidhje me punën e tij dhe atë të dëmtuarin B. B., Drejtor në shkollën “. . .” në Gjakovë, në atë mënyrë që si rrjedhojë e një mosmarrëveshje që kishin mes vete lidhur rreth një dëmi që e kishte shkaktuar djali i të pandehurit M.S, i cili e kishte dëmtuar derën e sallës së Edukatës Fizike, në shkollën “. . .”, ashtu që ditën kritike, i dëmtuari e kontakton me telefon të pandehurin për të biseduar rreth dëmit të shkaktuar nga fëmija i tij, i pandehuri në bisedë e sipër e ofendon të dëmtuarin me fjalët “*ta q.... familjen, nanën e babën*” dhe pastaj e kanos me fjalët “*vi aty të mbys, te vras dhe te copëtoj, ki me pa çka ka me të gjet ty*, me ç ‘rast tek i dëmtuari shkakton frikë, ankth dhe pasiguri për jetën e tij.**-me çka ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së.**

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë

mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza e cila nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 dhe 70 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethanë rënduese gjykata e konsideron faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale të kanosjes nga neni 181 par.3 lidhur me par. 2 të KPRK-së, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se i njëjti është i baba i katër fëmijëve, sjelljen e tij para kryerjes së veprës penale ka qenë korrekte, i pa punë dhe asnjëherë më parë nuk ka ra ndesh me ligjin, nuk ka qenë i dënuar. Në këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personalitetin e tij dhe i vetëdijshëm për pasojat e shkaktuara, është penduar thellë për veprën penale të kryer në afekt. Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari në çdo fazë të procedurës penale, shprehjen e keqardhjes për rastin që i ka ndodhur, kërkim falje publike, të cilat rrethana ndikuan që gjykata të zbatoj dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara në nenin 70 të KPRK-së, gjykata të akuzuarit i shqiptojë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8(tetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 2(dy) vite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimin i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës, pasi që gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka mundur që ta saktësojë lartësinë e dëmit që i akuzuari iu ka shkaktuar te dëmtuarve pasi që nuk ka asnjë ekspertizë apo konstatim për lartësinë e dëmit të shkaktuar.

Vendimi mbi shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 30.00 €, është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së,

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P.nr.101/22 më datë 05.07.2022**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.